



U.C.C.I.A.L

BASHKIMI I D'OMAVE TË TREGTISË DHE INDUSTRIËSË SHQIPËRISË
UNION OF CHAMBERS OF COMMERCE & INDUSTRY OF ALBANIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

“SHQIPËRIA PUNON TOKËN- KONSUMO SHQIP”

Dt 29-30 nëntor

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”

PROGRAMI

Në të dy krahët e rrugës do të vendosen stendat e ekspozimit duke krijuar kontakt të drejtepërdrejtë si me organizatorët ashtu edhe me shitësit / prodhuesit e produkteve përgjegjëse. Gjithashtu, në hapësirën në mes do të ketë argetim kulturor dhe ide zbavitëse të vendosura në praktikë (agrio-turizëm në miniaturë me materiale të ndryshme të riciklueshem ose produkte ushqimore; markata e Korçës dhe ajo e Tiranës në minaturë ideuar dhe bazuar mbi pamjet e tyre unike; dhe të gjithë bizneset, duke përfshirë elementet që gjenden të shtjelluara si me poshtë:

- Të gjithë ekspozitorët sugjerohen të vendosen në mini-stenda, duke ekspozuar aktivitetin ose produktet e tyre.

- Sporteli hyrës në panair (info point/modeli i sporteve unike) do të jetë pika e takimit fillestar për çdo të interesuar që do marrë pjesë, jo vetëm duke kërkuar informacion të ndryshëm, por edhe një vend takimi, orientimi dhe këshillimi. Hartat dhe skicat e ristrukturimit do të jenë në stendat hyrëse e sportelit.
- Këndi i gatimit do të vijë kësaj here si një risi me gjithë komponentët e saj avangarde, ku patjetër tradicionalja nuk do të mungojë në motive dhe përmbajtje. Ndërthurja e tyre do të jetë një nga surprizat më të bukura të këtij panairi dy ditor. Rëndësi do ti jepet edhe inkubatorëve që promovojnë produktet tona tradicionale.
- Agro-turizëm në miniature – shërben edhe si restorant. Pjesëmarrja e të gjithë trevave shqiptare do përbëjë thelbin e këtij panairi dhe prezantimi në shije dhe degustim do të jenë krenaria dhe domosdoshmëri nga ana e autoriteteve të panairit. Hapësira e madhe do t'i ngjajë një restoranti me një menu tepër të pasur ku gjithëkush të provojë diçka, të marrë informacion dhe të njihet me ushqime që ndoshta deri më sot nuk e ka pasur mundësinë.
- Vathë me kafshë të imta për ekspozim / kënd lojrash për fëmijë. Një nga stendat më interesante dhe më argetuese do t'i dedikohet fëmijëve.
- Kantina e verës për degustim vere dhe djathra nuk kanë si të mungojnë. Forma do të jetë tradicionale dhe do të përfshijnë elementet si: kade me vere, kazan rakie shishe me alkool vendi, fuçi birre etj
- Këndi i mjeteve të punimit të tokës me stendat e tjera që nevojiten për të gjitha proceset e përpunimit të tokës, si makineritë e ndryshme, por edhe mjetet artizanale, duke filluar nga me baziket e deri te traktorët e mëdhenj që revolucionarizuan fshatin shqiptar.
- Workshop area – program 2 ditor takimesh dhe aktivitësh nga institucioni, univeristet etj, me qëllim promovimin e iniciativave të Ministrisë së Bujqësisë. Njohja me planet dhe programet e ndryshme që do të ideohen dhe përpunohen

në të ardhmen. Ofrimi i bashkëpunimit do të jetë pika kyçe e çdo iniciative të re që mund të ndërmerret nga secila palë, qoftë ajo shtetërore, qoftë ajo private, por mund të jetë edhe individuale ose grupe te shoqërisë civile.

- Këndi i intervistave – gjate dy diteve, Ministri i Bujqësisë ka një agjendë daljesh mediatike në emisione të ndryshme, të cilat transferohen te panairi. Rrjetet sociale do të shpërndajnë informacione të ndryshme rreth panairit; gazetat dhe revistat do të botojnë lajme nga kjo stendë, ku marrja e çdo informacioni për të përgatitur lajmin ose reportazhin e rradhës rreth këtij eventit dy ditor do të jetë më e lehtë dhe më e organizuar.
- Ekranet e spoteve do të vendoset në një vend mjaft të dukshëm dhe i aksesueshëm nga çdokush. Në të do të prezantohen histori të ndryshme suksesi, të njohura ose të panjohura në syrin e publikut; do të shfaqen të dhëna grafike dhe rezultate në fusha të ndryshme të bujqësisë, etj.
- Zona e muzikës dhe skena show
- Festat tradicionale të çdo bashkie, do të shperfaqen në panairin SHQIPËRIA PUNON TOKËN.

Lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në adresën info@uccial.al